



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK



VENDIM

Nr. 188, datë 22.12.2023

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 4, 5, KATUND I RI DHE MANËZ, BASHKIA DURRËS, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR BANESAT INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019.

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit", i ndryshuar, Raportit me nr. 11234/1 prot., datë 14.12.2023 të Komisionit të Posaçëm miratuar nga kryetari i bashkisë, si dhe relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësitë Administrative nr. 4, 5, Katundi i Ri dhe Manëz, Bashkia Durrës, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26

nëntor 2019, hartuar nga Komisioni i Posaçëm sipas anekseve përkatëse, pjesë përbërëse e këtij vendimi si më poshtë:

- a. Aneksi 1, “Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative nr.4”.
 - b. Aneksi 2, “Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative nr.5”.
 - c. Aneksi 3, “Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative Katundi i Ri”.
 - d. Aneksi 4, “Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative Manëz”.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 22.12.2023

ANEKSI 1. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.4

NR	NUMRI APLIKIMIT	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	PËRBËRJA FAMILJARE	KONKLUZIONI AKTEKSPERTIZES	SUBJEKTE PERFITUESE
1	12873	KURT	SELMAN	SUCI	2	PERFORCIM	PO



ANEKSI 2. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.5

NR	NUMRI APLIKIMIT	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	PËRBËRJA FAMILJARE	KONKLUZIONI AKTEKSPERTIZES	SUBJEKTE PERFITUESE
1	11183	SELAUDIN	MAL	VAKAJ	2	PRISHJE	PO



ANEKSI 3. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE KATUND I RI

NR	NUMRI APLIKIMIT	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	PËRBËRJA FAMILJARE	KONKLUZIONI AKTEKSPERTIZES	SUBJEKTE PERFITUESE
1	73101	AGIM	QAZIM	BRAHAJ	5	PRISHJE	PO



ANEKSI 4. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE MANEZ

NR	NUMRI APLIKIMIT	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	PËRBËRJA FAMILJARE	KONKLUZIONI AKTEKSPERTIZES	SUBJEKTE PERFITUESE
1	16812	FERIK	SHABAN	BEQJA	2	PRISHJE	PO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS


Nr. 26/6 prot.

Durrës, më 29.12.2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.188 datë 22.12.2023 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në njësinë administrative nr.4,5, Katund i Ri dhe Manëz, Bashkia Durrës, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019 “.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhërësive me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një aktadministrativ me karkater individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

